

SHTYLLAT E NJË PLANI VIZIONAR TË QEVERISJES: Disa nga prioritetet kyçe për Qeverinë Kurti II

Prill 2021



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Grupi për Studime Juridike dhe Politike është institut i politikave publike, i pavarur, jopartiak dhe jo-fitimprurës.

GLPS është institut i vendosur në Prishtinë, Kosovë. Misioni ynë është që të realizojmë studime profesionale të politikave në fushën e së drejtës, politikës dhe ekonomisë, si dhe të avancojmë orientime politikash që adresojnë dështimet dhe/apo atakojnë problemet në fushat e caktuara.

SHËNIM POLITIKASH 02/2021

SHTYLLAT E NJË PLANI VIZIONAR TË QEVERISJES: DISA NGA PRIORITETET KYÇE PËR QEVERINË KURTI II

Autor: Njomza Arifi* dhe Rreze Hoxha Zhuja**

Prill 2021

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prill 2021.

Opinionet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e Grupit për Studime Juridike, donatorët, këshillit, stafit të tyre, apo anëtarëve të bordit. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo përdoret në çfarëdo forme pa leje paraprake. Për kërkesa të kësaj natyre kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. "Rexhep Luci", 16/1
Prishtinë 10 000, Kosovë
Ueb: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 234 456

*Menaxhere e Programeve, Grupi për Studime Juridike dhe Politike

**Hulumtuuese, Grupi për Studime Juridike dhe Politike

SHTYLLAT E NJË PLANI VIZONAR TË QEVERISJES: DISA NGA PRIORITETET KYÇE PËR QEVERINË KURTI II

HYRJE

Edhe pse në dekadën e dytë të shtetësisë, Kosova nuk po arrin ende të përparojë siç duhet në rrugën e saj drejt shtet-ndërtimit dhe fuqizimit të njohjes së shtetit të ri në arenën ndërkombëtare. Mungesa e vazhdueshme e stabilitetit politik ka bërë që Kosova të gjendet në vazhdimësi në një cikël të çrregullt qeverisjeje, pa asnjë reformë thelbësore të implementuar deri në fund.

Viti 2020, sikurse të gjithë botën, e gjeti Kosovën në mes të një krize të thellë shëndetësore dhe një virusi vdekjeprurës. Pandemia COVID-19 shpërfaqti edhe më tutje brishtësinë e sistemit shëndetësor në Kosovë, duke thelluar kështu edhe më tutje faktin që tashmë 20 vite pas lufte, qeveritë e Kosovës kanë dështuar që të krijojnë një sistem adekuat shëndetësor për qytetarët e saj. Detyrimisht, mbyllja si pasojë e pandemisë u përcoll edhe me një krizë të thellë ekonomike e cila solli shumë biznese buzë greminës. Për më tepër, shumë reforma stagnuan dhe një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të Kosovës u koncentrua drejt menaxhimit me pandeminë.

Megjithatë, në një mënyrë të paprecedentë, në mes të pandemisë dhe përmes një mocioni mosbesimi, u rrëzua Qeveria Kurti për t'u zëvendësuar me atë të udhëhequr nga Hoti që vinte nga radhët e LDK-së, njëherësh edhe ish partner koalicioni i qeverisë paraprake.¹ Se sa i ngulitur është jostabiliteti politik në Kosovë flet edhe fakti që brenda vitit 2020, qytetarët e Kosovës përjetuan tri qeveri të ndryshme: qeverinë Haradinaj në ikje, qeverinë 51 ditëshe Kurti, si dhe qeverinë Hoti e cila u krijua në Qershor 2020 dhe zgjati deri në fund të Dhjetorit. Kjo e fundit u shpërbësi pasojë e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese e cila shpalli të pavlefshme votën e deputetit Etem Arifi për shkak të dënimit të formës së prerë i cili rëndon mbi të për korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare.²

Në këto 13 vite pas shpalljes së Pavarësisë, Kosova vazhdimisht është karakterizuar me ndryshime koalicionesh qeveritare, rritje megalomane të dikastereve qeveritare për t'i akomoduar apetitet politike të partnerëve të koalicioneve, politizim të bordeve dhe agjencive, shtet ligjor fragjil dhe të ndikuar nga politika, dhe një proces të rëndë dhe të gjatë dialogues me Serbinë. E ky i fundit, ndër të tjera, është karakterizuar me përfaqësim të dobët, në mungesë të konsensusit, dhe të një platforme konkrete.

Kjo Analizë synon të ofroj rekomandime konkrete për prioritetet kyçe në shtatë shtylla të politikbërjes në Kosovë, për të cilat GLPS mendon që duhet të futen menjëherë në planin strategjik të qeverisë së re. Më tutje, raporti ofron rekomandime të qarta afatshkurtra dhe afatgjate aty ku është e mundur, si dhe disa propozime se si të i qaset secilës nga prioritetet e propozuara. Në të shumtën e rasteve, të njëjtat lidhen me një vullnet politik për të arritur progres të shtuar në reformat e nevojshme për përafrim me Bashkimin Evropian, reforma në administratë publike, vetingu në sektorin e drejtësisë, zhvillimi ekonomik dhe tërheqja e investitorëve të huaj, përmirësimi i mirëqenies qytetare përmes skemave sociale të realizueshme në praktikë, si dhe investimi adekuat, dhe përmirësimi në arsim dhe shëndetësi. Natyrisht, urgjenca e parë dhe e pakontestueshme mbetet menaxhimi me COVID-19, imunizimi i popullsisë dhe rimëkëmbja ekonomike.

¹ The Guardian, Shaun Walker, "Kosovarët të tronditur se si bie qeveria në mes të pandemisë," 26 mars 2020. Linku: <https://www.theguardian.com/world/2020/mar/26/kosovo-government-falls-in-vote-of-no-confidence>

² Gjykata Kushtetuese, KO95/20, Aktgjykim i miratuar më 21 dhjetor 2020, publikuar më 6 janar 2021. Linku: <https://bit.ly/3cUhXN4>

I. MENAXHIMI ME COVID-19 DHE REFORMA NË SHËNDETËSI

Një ndër prioritet kryesore të qeverisë së re duhet të jetë, padiskutim, menaxhimi i mëtutjeshëm me pandeminë COVID-19. Në terma afatgjatë përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit shëndetësor në Kosovë, përmes reformave të thella është parakusht për të përmirësuar gjendjen në këtë sektor. Masat e para kundër pandemisë u ndërmorën menjëherë pas shfaqjes së rasteve të para me COVID-19 në Kosovë.³ Edhe pse fillimisht me një gjendje relativisht nën kontroll, në gusht të 2020, Kosova përfundoi me një situatë alarmante, duke u renditur nga vendet me vdekshmërinë më të lartë si pasojë e COVID-19.⁴ Në nëntor të po të njëjtit vit, numri mesatar i rasteve ditore arriti në 715 sosh.⁵ Për më tepër, Kosova u karakterizua vazhdimisht për numër shumë të ulët testimesh në krahasim me vendet e tjera në rajon⁶, e duke i shtuar ato vetëm nga fundi i vitit 2020. Situata me pandeminë shpërfaqti edhe me tej problemet në shëndetësi, përfshi këtu edhe kapacitetet e limituara për hospitalizim, mungesën e shërbimeve adekuate, si dhe keqmenaxhimin me shëndetësinë përgjatë gjithë këtyre viteve të pasluftës, në përgjithësi.

Gjatë pikut të infektiveve, personeli shëndetësor nuk kishte para vetës as mjetet themelore të punës për të trajtuar pacientët e infektuar. Pandemia vuri në dukje se investimet ndër vite në sistemin e shëndetësisë ishin të mangëta dhe jo-efikase. Shumicën e rasteve, vendimet e marra për menaxhimin e pandemisë u bënë në formë 'ad-hoc' dhe jo si pjesë e një strategjie apo sistemi tashmë të mirëstrukturuar. Përfundimisht, koncentrimi në politikë dhe jo në menaxhimin më të mirë të pandemisë, shkaktoi probleme shtesë gjatë kësaj kohe, e të cilat mbesin ende evidente. Në anën tjetër, përshkak të kapaciteteve të limituara, gjatë pandemisë u shkelën të drejtat e mijëra pacientëve të cilët marrin shërbime të rregullta spitalore si pasojë e sëmundjeve kronike.⁷ Të rikujtojmë se Raporti për Vendin i publikuar vitin e kaluar nga Komisioni Evropian theksoi se Kosova ka bërë shumë pak progres sa i përket strategjisë së sektorit të shëndetësisë dhe një numër konsiderueshëm i lartë qytetarësh kanë qasje të limituar në shërbime shëndetësore.⁸ Thënë këto më lartë, GLPS konsideron që situata me pandeminë do të thellojë problemet aktuale në sistemin e shëndetësisë, nëse qeveria nuk ndërmerri veprime të menjëhershme në adresimin e problemeve të shumta që u identifikuan gjatë kësaj krize shëndetësore, por edhe me herët.

Në këtë drejtim, GLPS i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës prioritetet si më poshtë:

Objektiva 1: Vaksinimi i së paku 50% të popullsisë – Asgjë nuk mbetet më e rëndësishme dhe prioritare në këtë periudhë sesa imunizimi i popullsisë nga COVID-19. Qeveria e Kosovës duhet mobilizuar menjëherë që të sigurojë vaksina të mjaftueshme dhe të rregullta për muajt në vijim. Për të arritur këtë, Kosova duhet të kërkojë mbështetje nga Bashkimi Evropian, por edhe partnerët trans-atlantik, të cilat kanë dhënë indikacione të qarta për të mbështetur Kosovën në këtë

³Zëri i Amerikës, "Kosova një vit pas konfirmimit të të infektuarve të parë me COVID-19", E. Bllaca, 14 Mars 2021. Linku: <https://bit.ly/3uBgZLX>

⁴"Kombi më i ri në Evropë do rris numrin e testeve në mes të një goditje të re të COVID-19", Bloomberg, J. Kuzmanovic & M. Savic, 29 gusht 2020. Linku: <https://bloom.bg/2OuKT9Q>

⁵ Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim - OECD, "Kriza e COVID-19 në Kosovë", 31 Janar 2021. Linku: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>

⁶ Top Chanel, "COVID-19/ Shqipëria dhe Kosova, vendet me më pak teste në Ballkan", 29 prill 2020. Linku: <https://top-channel.tv/video/covid-19-shqipëria-dhe-kosova-vendet-me-me-pak-teste-ne-ballkan/>

⁷ Banka Botërore, "Ndikimi i COVID-19 në sistemet shëndetësore në Ballkanin Perëndimor". Linku: <https://pubdocs.worldbank.org/en/496311590709947974/RER-Health-May-21-for-tyset-ALB.pdf>

⁸ Komisioni Evropian, Raporti për Vendin 2020 (fq. 82), 6 Tetor 2020. Linku: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

drejtim. Një rol të shtuar në këtë drejtim ka edhe Kryeministri Kurti i cili duhet të intensifikojë përpjekjet për të siguruar ato. Në të njejtën linjë, qeveria duhet të hartojë një plan vaksinimi dhe të synojë që më së largu deri në fund të vitit 2021 të vaksinonjë së paku 50% të popullsisë. Kosova mbetet shteti i fundit në rajon që ka filluar të pranojë vaksina, përderisa shtetet fqinje tashmë kanë plane të qarta në këtë drejtim.⁹ Për të bërë vaksinimin në mënyrë të duhur, qeveria duhet të sigurohet në zbatimin e drejtë të planit të veprimit për vaksinim të popullsisë, duke u dhënë prioritetet personelit shëndetësor dhe pastaj të gjitha grupet tjera sipas nivelit të rrezikshmërisë. Në të njejtën kohë, duhet gjithashtu të krijohet infrastruktura e nevojshme për të implementuar këtë proces, duke përfshirë edhe digjitalizimin e të dhënave të vaksinuarve. Qeveria duhet të angazhohet për një proces sa më transparent, dhe të mos lejojë në asnjë mënyrë vaksinimin selektiv. Me rastin e sigurimit të sasisë së vaksinave, Ministria e Shëndetësisë duhet që paralelisht të zhvillojë një fushatë sensibilizuese për t'i inkurajuar qytetarët që të vaksinohen, dhe kështu të eliminojë zërat e mundshëm që janë skeptikë drejt një gjëje të tillë.

Objektiva 2: Testim i rregullt dhe i shtuar – Duke marrë shembull vendet e rajonit por edhe ato të BE-së, në mënyrë të parandalimit të vatrave të reja të infeksionit, qeveria e Kosovës duhet të sigurojë testime të shtuara dhe të rregullta për të gjitha variantet e shfaqura të virusit. Qeveria e Kosovës duhet të ketë një plan të qartë se si të reagojë ndaj emergjencave të tilla, siç mund të jetë mungesa e testeve gjatë pandemisë. Poashtu, brenda periudhës së parë tre mujore të Qeverisë Kurti II, të sigurohen të gjitha mjetet e nevojshme të punës, përfshirë këtu barnat esenciale, maska, dorëza dhe mjete të tjera të punës. Përfundimisht, Kosova duhet të mbetet shumë e vëmendshme në identifikimin e ekzistencës së varianteve të reja në vend, dhe për t'a bërë këtë, institucionet përkatëse duhet angazhuar që të nisin sa më shumë mostra jashtë vendin për analizë të mëtutjeshme të tyre.

Objektiva 3: Të bëhet një vlerësim i tërësishëm i pasojave të pandemisë në sistemin shëndetësor në Kosovë – Brenda periudhës së parë gjashtë mujore, Qeveria e Kosovës duhet të dalë me një raport të detajuar që ofron një analizë të thellë lidhur me pasojat që pandemia COVID-19 ka shkaktuar në sistemin shëndetësor në Kosovë. Një analizë e tillë duhet të shërbejë si udhërrëfyes për përcaktimin e prioriteteve shëndetësore dhe implikimeve të nevojshme buxhetore për të sanuar këto probleme në mënyrë të vazhdueshme.

Objektiva 4: Mbrojtja e të drejtave të pacientëve të cenueshëm – Është shumë e rëndësishme që Qeveria e Kosovës të hartojë një strategji afatgjatë mbi mbrojtjen e të drejtave të pacientëve të cenueshëm, atyre me sëmundje kronike, sëmundje kancerogjene dhe të gjithë atyre që kanë nevojë për kujdes të rregullt shëndetësor.

Objektiva 5: Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve shëndetësore në klinika, spitale dhe qendra të kujdesit shëndetësor, në nivel qendror dhe lokal – Decentralizim i mëtutjeshëm i shërbimeve mjekësore.

Objektiva 6 – Sigurimet shëndetësore – Edhe pse, Ligji i ri për Sigurime Shëndetësore u miratua nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2014, ai asnjëherë nuk u jetësua në praktikë përshkak të mungesës së vullnetit politik dhe institucional.¹⁰ Një gjë e tillë ka rënduar shumë xhepin e qytetarëve të Kosovës. Kësisoj qindra mijëra euro shpenzohen nga qytetarët e Kosovës në

⁹“Kosova, vendi i vetëm në Ballkan që s’ka marrë asnjë dozë vaksine”, Top Channel, 25 shkurt 2021. Linku: <https://top-channel.tv/2021/02/25/kosova-vendi-i-vetem-ne-ballkan-qe-ska-marre-asnje-doze-vaksine/>

¹⁰“Pa sigurime shëndetësore në pandemi”, L. Krasniqi-Veseli, Evropa e Lirë, 6 mars 2021. Shih: <https://www.evropaelire.org/a/31136913.html>

klinika private brenda dhe jashtë vendit. Prandaj, mbetet shumë e rëndësishme që brenda vitit 2021 të bëhen ndryshim plotësimet e nevojshme në Ligjin për Sigurime Shëndetësore, të finalizohet drafti i Fondit për Sigurime Shëndetësore me të gjitha shërbimet përkatëse dhe qytetarët e Kosovës të pajisen me sigurim shëndetësor brenda këtij viti.

Objektiva 7 - Modernizim i shërbimeve mjekësore dhe funksionalizimi i sistemit informativ shëndetësor– Modernizimi i vazhdueshëm i sistemit shëndetësor në Kosovë duhet të jetë një nga qëllimet afatgjate dhe të vazhdueshme të qeverisë. Në këtë drejtim, qeveria duhet të vlerësoj kapacitetet aktuale dhe të siguroj mjete buxhetore për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve shëndetësore, qoftë përmes pajisjeve mjekësore inovative apo edhe digjitalizimit të shërbimeve, aty ku është e mundur.

Objektiva 8 - Mbajtja e trurit në Kosovë – investimi në profesionistët shëndetësor – Ndër vite, Kosova është përballur me një migrim shqetësues të profesionistëve shëndetësor drejt vendeve të Bashkimit Evropian, madje edhe gjatë periudhës së pandemisë.¹¹Ndër arsyt kryesore të këtij fenomeni është mungesa e kushteve adekuate të punës, mundësitë e punësimit në përgjithësi, si dhe mungesa e një vizioni të qartë mbi investimin e vazhdueshëm në profesionistët shëndetësor në Kosovë. Thënë këtë, mbetet shumë e rëndësishme që qeveria të ndërmarrë masa të menjëhershme në adresimin e kësaj sfide, dhe të angazhohet që brenda një periudhe shumë të shkurtë kohore të hartoj një strategji se si të parandaloj ikjen e profesionistëve shëndetësor nga vendi. Nëse ky trend vazhdon kështu si është, sistemi rrezikon të kolapsoj në një të ardhme jo të largët.

Objektiva 9 - Anëtarësimi në Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH) –Një nga objektivat kryesore të qeverisë duhet të jetë përgatitja për aplikim për t'u antarësuar në Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Qeveria e re nuk duhet humbur kohë për t'u angazhuar në këtë drejtim, dhe të synoj që një gjë të tillë t'a arrij brenda vitit të parë të qeverisjes. Anëtarësimi në OBSH mbetet qenësor për Kosovën, si në terma të mbështetjes që do ofrohej, por edhe në rrafshin e përfaqësimit në mekanizma ndërkombëtarë relevantë.

II. Rimëkëmbja dhe Zhvillimi Ekonomik

Krahas menaxhimit me pandeminë, Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për sanimin e pasojave që solli COVID-19 në ekonominë e vendit.Duhet bërë një analizë të thellë të dëmeve në të gjithë sektorët ekonomik dhe të hartohet një plan që adreson nevojat e menjëhershme të sektorit privat. Një aspekt shumë i rëndësishëm që u vu edhe më shumë në pah nga pandemia është edhe informaliteti jashtëzakonisht i lartë në Kosovë.¹² Pandemia na mësoi për rëndësinë e zbatimit të kontratave të punës, dhe përmbushjen e detyrimeve. Kosova vazhdon të mbes ndër vendet më të pazhvilluara ekonomikisht dhe me të ardhura më të ulta për kokë banori në Evropë. Në të njëjtën kohë, Kosovës vazhdon t'i mungoj një identitet ekonomik dhe një analizë e thellë mbi sektorët të cilët kanë potencial më të lartë zhvillimi. Njësoj, vendi nuk ka arritur të tërheq investime të huaja direkte dhe kjo si pasojë e dështimit të qeverive paraprake për t'iu siguruar investitorëve potencialë një ambient të duhur të të bërit biznes. Poashtu, mungesa e konkurrueshmërisë në tregjet ndërkombëtare ka bërë që

¹¹ "Mjekët po ikin edhe gjatë pandemisë, mbi 100 lëshuan Kosovën në 2020-tën", Insajderi, Janar 2021. Linku: <https://insajderi.com/mjeket-po-ikin-edhe-gjate-pandemise-mbi-100-leshuan-kosoven-ne-2020-ten/>

¹²"Mbi 31% e ekonomisë së Kosovës është joformale", Ekonomia Online, 24 prill 2018. Linku: <https://ekonomiaonline.com/ekonomi/mbi-31-e-ekonomise-se-kosoves-eshte-joformale/>

bilanci tregtar në vend të vazhdoj të jetë negativ. Si një vend me të gjitha këto probleme ekonomike, konsideruar këtu edhe pasojat e rënda nga COVID-19, qeveria nuk ka kohë për të humbur në këtë drejtim. Qeveria duhet angazhuar fillimisht në sanimin e problemeve të shpërfaqura nga pandemia, dhe njëkohësisht, në hartimin e politikave kualitative të cilat si qëllim final kanë zhvillimin ekonomik, rritjen e eksportit, fuqizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e përkrahjen dhe promovimin e prodhimeve vendore, ndër të tjera. Përfundimisht, krijimi i një ambienti funksional dhe zhvillimor ekonomik do të ndikonte direkt në uljen e shkallës së lartë të papunësisë dhe rritjen e mirëqenies sociale në vend. GLPS konsideron që institucionet përkatëse duhet të angazhohen në ndërmarrjen e një sërë reformash substanciale që për qëllim do të kishin përmirësimin e mjedisit ekonomik, fiskal, dhe atij financiar. GLPS i propozon qeverisë disa nga objektivat kyçe të listuara më poshtë:

Objektiva 1: Implementimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike: Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike u aprovua në gusht të vitit 2020 dhe ka një vlerë totale prej 365 milionë euro. Sipas një raporti të Institutit GAP, gjatë vitit 2020 janë shpërndarë 250 milionë euro nga totali i lartëpërmendur.¹³ I njëjti konstaton se implementimi i kësaj pako është përballur me mungesë transparence dhe pa asnjë kriter mbi atë se cilat biznese u dëmtuan më shumë, por u ndanë në mënyrë proporcionale, madje edhe për ata që shënuan performancë të rritur gjatë izolimit. Qeveria e Kosovës duhet të sigurohet që pjesa e mbetur e mjeteve të shpërndahet në mënyrë tërësisht transparente dhe të ketë për qëllim të ndihmoj sektorët më të prekur. Në të njëjtën kohë, qeveria poashtu duhet të angazhohet që edhe mjetet e ndara nga qeveria paraprake të bëhen publike sa më parë. Përfundimisht, implementimi i drejtë i pakos së kaluar, por edhe iniciimi i pakove të reja për ndihmë kundrejt sektorëve të prekur duhet të mbetet prioriteti kryesor ekonomik i kësaj qeverie.

Objektiva 2: Lufta kundër informalitetit: GLPS konsideron se lufta kundër ekonomisë joformale duhet të jetë ndër prioritetet kryesore të Qeverisë Kurti II, dhe se një gjë e tillë duhet të bëhet në koordinim të plotë me institucionet përgjegjëse. Me vite të tëra sektori privat ka qenë i karakterizuar nga një informalitet i lartë, në mungesë kontratash dhe kushtesh ashtu siç përcaktohen me legjislacionin përkatës. COVID-19 e shpërfaqti edhe më tutje shkallën e lartë të informalitetit në Kosovë në momentin që u mundësua tërheqja e 10% të mjeteve të Trustit e poashtu edhe ndarja e ndihmës nga pakoja emergjente e qeverisë. Në vitin 2019, qeveria e atëhershme pati rishikuar strategjinë dhe planin e veprimit për luftën kundër informalitetit për periudhën 2019-2023 dhe e cila duhet menjëherë të gjej implementimin e duhur në praktikë. Duhet të ketë një bashkëpunim të shtuar mes qeverisë, Doganës dhe ATK-së, ndër të tjera. Poashtu, një rol të rëndësishëm luajnë institucionet përkatëse të drejtësisë të cilat janë të mveshura me përgjegjësinë e ndjekjes dhe dënimit të praktikave të joformalitetit dhe keqpërdorimeve të mundshme doganore. Konsideruar të gjitha këto më lartë, qeveria duhet të angazhohet në implementimin e duhur të Ligjit të Punës, zbatimin e kontratave në sektorin privat dhe vetëdijësimin e punëdhënësve por edhe të të punësuarve mbi rëndësinë e punësimit me kontratë të rregullt dhe përfitimet që vijnë me të. Poashtu, duhet promovuar digjitalizimi i transaksioneve në mënyrë që të evitohen të njëjtat që bëhen me para të gatshme, të synohet pajisja me arkë fiskale në mënyrë të tërësishme në sektorin privat, dhe ATK-së t'i ofrohen kapacitetet e mjaftueshme për të reduktuar evazionin fiskal në minimum, po që se të njëjtat mungojnë.

¹³ "Programi dhe Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike Transparenca dhe kriteret e përdorura gjatë zbatimit", Instituti GAP, Mars 2021. Linku: [https://www.institutigap.org/documents/26680_kriteret_rimekembjes\(f\).pdf](https://www.institutigap.org/documents/26680_kriteret_rimekembjes(f).pdf)

Objektiva 3: Ristrukturimi i ndërmarrjeve publike: Përgjatë viteve të pasluftës, ndërmarrjet publike kanë hasur në një degradim të vazhdueshëm, e disa prej tyre funksionojnë me humbje të mëdha siç janë Posta, Infrakosi, Telekomit e shumë të tjera.¹⁴ Ndërmarrjet e lartëpërmendura dikur kanë qenë kryesoret në mbushjen e arkës së shtetit, ndërsa tani të njejtat detyrohen të kërkojnë ndihmën e shtetit për të mbijetuar, duke u kthyer kështu në barrë për Kosovën. Për këtë arsye, riskstrukturimi i tyre duhet të jetë ndër prioritetet kryesore për qeverinë Kurti II. Ngjashëm, qeveria duhet të ndërmarrë edhe veprime konkrete në rivitalizimin e Trepçës dhe ndërmarrjeve të ngjashme, të cilat mundësojnë ndër të tjera, shfrytëzimin e pasurive natyrore të vendit, në të mirë të zhvillimit ekonomik. Njësoj i rëndësishëm mbetet edhe depolitizimi i ndërmarrjeve publike në Kosovë.

Objektiva 4: Politika të qëndrueshme të fuqizimit të kapaciteteve në sektorin energjetik të Kosovës: Mungesa e furnizimit të rregullt me energji elektrike vazhdon të mbetet shqetësim i kamotshëm në Kosovë. Qeveria e re duhet të angazhohet në sigurimin e kapaciteteve të reja energjetike. Fillimisht, ajo duhet të hartoj një strategji të qartë të investimeve që zgjidh problemin e mungesës së energjisë elektrike, dhe e cila mbështetet në standardet ndërkombëtare, e veçanërisht ato të kërkuara nga BE-ja. Orientimi drejt energjisë së ripërtishme mbetet parakusht në këtë sektor, prandaj qeveria duhet të konsideroj të gjitha burimet alternative të ngritjes së kapaciteteve energjetike, me qëllim të uljes së prodhimit tërëgjithshëm. Përfundimisht, furnizimi me energji elektrike duhet të bëhet konform politikave dhe standardeve mjedisore të kërkuara nga Bashkimi Evropian.

Objektiva 5: Investimet e Huaja Direkte dhe Diaspora: Qeveria duhet të përpiloj një strategji funksionale për tërheqjen e investimeve të huaja direkte pasi që të njejtat mbesin parakusht për zhvillimin ekonomik të vendit, marrë parasysh faktin që Kosova, si shtet në ndërtim e sipër, nuk ka potencial të mjaftueshëm të zhvillohet nga brenda. Në anën tjetër, qeveria duhet konsideruar potencialin e madh të diasporës duke i'u ofruar të njejtëve mjedis të favorshëm për të investuar.

Objektiva 6: Identifikimi i sektoreve strategjike dhe fuqizimi i tyre: Një aspekt tjetër me rëndësi për ekonominë e vendit është edhe identifikimi i sektorëve strategjik dhe me potencial të lartë zhvillimi dhe të njëjtat të fuqizohen tutje përmes përkrahjes direkte nga shteti, qofshin ato prodhuese apo të ofrimit të shërbimeve. Kjo do krijonte një identitet ekonomik për Kosovën, gjë që deri tani ka munguar.¹⁵ Poashtu, angazhim i vazhdueshëm kërkohet në përkrahje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe subvencionimi i drejtë i prodhuesve vendor për t'u bërë konkurrues në tregun e BE-së.

Objektiva 7: Rishikimi i lejeve ekonomike dhe implementimi i strategjive përkatëse: Qeveria duhet të rishikoj të gjitha liçencat dhe lejet ekonomike të dyshimta e të cilat mund të jenë lëshuar mbi premisa të interesit të ngushtë financiar ose politik. Lejet ekonomike duhet lëshuar vetëm mbi parime meritore, transparente dhe me qëllim të menjanim të monopoleve të ndryshme, siç ka ndodhur deri tani. Në terma afatgjatë, vëmendje e rregullt i duhet kushtuar implementimit të Programit për Reforma në Ekonomi (2021-2023).

¹⁴ "Telekomi buzë bankrotit, Qeveria "shpëtim" e sheh shitjen", Koha.net, D. Neziri, 4 maj 2019. Linku: <https://bit.ly/3wyVTzq>

¹⁵ "Cilat janë prioritetet më të mëdha të qeverisë së re të Kosovës?", Euroactiv, D.Doli, 19 Mars 2021. Linku: <https://bit.ly/3mpUZAC>

III. Sundimi i Ligjit dhe Lufta Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Kosova karakterizohet vazhdimisht me një sistem të drejtësisë të brishtë dhe jo efikas. Ndër vite, raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe ato të shoqërisë civile karakterizojnë Kosovën si një vend ku sundimi i ligjit është në faza të hershme, jo efikas dhe i politizuar thellë.¹⁶ Edhe përtej ndihmës së pakusht të komunitetit ndërkombëtar në fuqizimin e kapaciteteve të sektorit të drejtësisë, vendi ende ballafaqohet me probleme të vazhdueshme të cilat cenojnë të drejtat e njeriut dhe demokracinë në vend. Pavarësisht që shumë reforma janë nisur në këtë drejtim, asnjëra nga to nuk ka arritur të përmirësoj situatën aktuale dhe shumë shpesh reformat e tilla nuk kanë sjellë ndonjë impakt të mirëfilltë, madje shumë shpesh të njëjtat kanë mbivendosur njëra-tjetrën.

Në anën tjetër, niveli i lartë i korrupsionit vazhdon të jetë prezent në të gjitha hallkat e shtetit dhe të gjitha nivelet institucionale, dhe madje është shndërruar në normë shoqërore. Prej më shumë se dy dekadash pas luftës, Kosova vazhdon të ketë rangim shqetësues në Transparency International dhe në çdo raport tjetër kredibil që bënë matje të ngjashme periodike. Madje, në vitin 2020, Kosova shënoi rënie duke u ranguar 2 pikë më keq se vitin paraprak, dhe pas vendeve sikurse Etiopia, Tanzania, etj¹⁷. Parakusht për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit mbetet funksionimi i shtetit të së drejtës. Mirëpo, sikurse në të kaluarën, institucionet përgjegjëse në këtë drejtim siç janë gjykatat, prokuroria, policia dhe agjencitë e ndryshme relevante vazhdojnë të mos tregojnë përkushtueshmëri dhe vullnet të mjaftueshëm për të përmirësuar situatën në këtë sektor kaq të rëndësishëm. Niveli i lartë i korrupsionit ndikon në zhvillim demokratik dhe ekonomik të shtetit. Ndër të tjera, mbetet indikator kyç në rrugën e Kosovës drejt integritimit evropian, si dhe konsolidimit të mëtutjeshëm të shtetësisë së Kosovës. Në të njëjtën kohë, ky fenomen ka ndikim të drejtpërdrejtë në prosperitetin ekonomik të vendit, duke pamundësuar krijimin e kushteve të nevojshme për investime të huaja direkte.

Në edicionin e gjashtë të Indeksit të Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë hartuar nga Drejtësia Sot, qytetarët e Kosovës vazhduan të shfaqin pakënaqësinë e tyre me këtë sektor. Të dhënat e dala nga anketa e realizuar tregojnë që mbi 58% e qytetarëve vazhdojnë të mendojnë se sektori i drejtësisë mbetet jo efikas dhe pa përmirësime të theksuara¹⁸. Për më tepër, më shumë se gjysma e qytetarëve vazhdojnë të mendojnë se politika është e aminstuar nga drejtësia dhe se institucionet përkatëse nuk po arrijnë t'i ndjekin dhe dënojnë figurat e larta politike të përfshira në vepra korruptive dhe krim të organizuar. Rastet e korrupsionit të profilin të lartë vazhdojnë të mbesin një shqetësim i vazhdueshëm dhe japin një pasqyrë shumë të qartë të faktit se sa i politizuar vazhdon të mbetet ky sektor. Thënë të gjitha këto më lartë, përfundimisht, forcimi i sundimit të ligjit mbetet thelbësor për zhvillimit e mëtutjeshëm të vendit. Edhe pse legjislacioni në Kosovë është i mirë harmonizuar me standardet e BE-së, implementimi në praktikë mbetet sfidë e vazhdueshme. Në këtë drejtim, GLPS propozon disa nga prioritetet kryesore si më poshtë:

¹⁶“Korrupsioni - kryefjalë e raporteve të Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën”, Kallxo.com, E. Vllahu, 01 prill 2021. Linku: <https://bit.ly/3fPUjDi>

¹⁷Indeksi i perceptimit të Korrupsionit, Transparency International, Linku: <https://www.transparency.org/en/cpi/2020/index/ksv>

¹⁸ “Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë – Edicioni i Gjashtë”, fq.14, Drejtësia Sot, Nëntor 2020. Linku: http://www.rolpik.org/wp-content/uploads/2020/12/RoLPIK6_SHQ.pdf

Objektiva 1 - Vetingu në sistemin e drejtësisë – Reforma e parë dhe më e rëndësishme që duhet nisur menjëherë për të arritur të përmirësohet ky sektor mbetet procesi i vetingut në sistemin e drejtësisë. Nevoja për veting tanimë nuk duhet diskutuar, por ajo çfarë duhet bërë menjëherë është gjetja e modaliteteve për realizimin e suksesshëm të këtij procesi.

Vetingu vjen si rezultat i problemeve të thella që kanë karakterizuar sektorin e drejtësisë që nga paslufta në Kosovë, dhe kjo është mungesa e rezultateve konkrete, jo efikasiteti, ndikimi politik, korrupsioni i shtuar, dhe më e rëndësishmja mungesa e profesionalizmit të institucioneve të drejtësisë në vend. GLPS konsideron që problemet në sektorin e drejtësisë shpërfaqen më së shumti si rezultat i kapaciteteve dhe profesionalizimit të munguar të personave të angazhuar në këtë sektor, sesa si pasojë e legjislacionit apo rregullimit aktual të infrastrukturës së punës. Prandaj, për të arritur rezultate konkrete, cilësia, efektiviteti, pavarësia dhe paanëshmëria duhet të jenë katër nga elementet kryesore që duhet të jenë subjekt vlerësimi përmes vetingut.

Qeveria Kurti II duhet të filloj menjëherë angazhimin me grupet relevante të interesit, përfshirë ekspertët e fushës, në mënyrë që të dizajnojnë reformën e vetingut dhe të hartojnë një plan veprimi për implementimin e këtij procesi brenda këtij mandati. Vetingu në sistemin e drejtësisë duhet të jetë proces i vazhdueshëm, i cili realizohet në baza periodike. Qeveria e Kosovës duhet të nxjerrë mësimet nga procesi që është realizuar në Shqipëri, dhe kështu të evitohet dështimet eventuale të cilat mund të rrezikojnë funksionimin e sektorit të drejtësisë në përgjithësi.

Subjekt vetingu duhet të jenë i gjithë personeli i institucioneve të sektorit të drejtësisë, përfshirë gjyqtarët, prokurorët, policinë dhe institucionet e tjera të sigurisë në vend, dhe jo vetëm. Këta zyrtarë duhet vetuar mbi disa parime kryesore, siç janë: integriteti etik, niveli i profesionalizimit, afërsia me qarqet kriminale apo politike, dhe prejardhja e pasurisë.

Objektiva 2 - Reformimi i sistemit të disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve - I tërë sistemi dhe Ligji për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve është ndërruar në vitin 2018. Si i tillë, ky sistem ka probleme rrënjësore të cilat bëjnë të pamundur disiplinimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për të përmirësuar situatën në këtë drejtim, GLPS i propozon qeverisë që të ndër marrë disa hapa si mëposhtë:

- Duhet të adresohet koncepti i palës dhe i njejtë duhet bërë në kuadër të standardeve ndërkombëtare. Kështu siç është, i mohon palës së dëmtuar të jetë pjesë e procedurës në tërësi (veçanërisht, palës së dëmtuar i mohohet e drejta e ankesës së vendimit të Këshillit në Gjykatën Supreme).
- Duhet adresuar faktin që Gjykata Supreme është shkalla e dytë dhe përfundimtare në këtë procedurë. Njëkohësisht, e njejtë ka këtë kompetencë edhe kur bëhet fjalë për gjyqtarët e kësaj gjykate (pra koleget i vlerësojnë sjelljet e kolegeve të tyre, si shkallë e dytë dhe përfundimtare).
- Duhet adresuar edhe mungesa e përvojës dhe njohurive të paneleve për disiplinim që formohen në kuadër të Këshillave.

Objektiva 3 –Fuqizimi i drejtësisë administrative - Drejtësia Administrative vazhdon të jetë sfiduese dhe kjo shpërfaqet më së miri në raportet e viteve të fundit për vendin të publikuara nga Bashkimi Evropian. Problemet janë si në aspektin e rregullimit, organizimit dhe po ashtu edhe në grumbullimin e lëndëve që në fund rezultojnë me mbrojtje të dobët gjyqësore të të drejtave subjektive të palëve kundrejt autoriteteve publike. Që nga vitin 2016 është filluar që të punohet në rregullimin e kornizës ligjore, në atë kohë nga ish Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim të ngushtë me SIGMA/OECD dhe është arritur që

përfundimisht të hartohet Projektligji për Konfliktet Administrative, i cili i jep zgjidhje problemeve të grumbulluara në drejtësinë administrative. GLPS i propozon qeverisë që të përshejtoj të gjitha procedurat e nevojshme që ky ligj të procedohet dhe miratohet nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ky ligj ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes gjyqësore të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të palëve kundër veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme të kryera gjatë ushtrimit të autoritetit publik. Si i tillë, i njëjti duhet menjëherë të miratohet, në mënyrë që të menjanohen problemet që kanë lindur vazhdimisht si pasojë e mungesës së një rregullimi të tillë.

Lufta Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Mungesa e vullnetit institucional dhe politik për të dëshmuar rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe jo vetëm, reflekton direkt në ngecjen e Kosovës drejt progresit për integrim në Bashkimin Evropian. Për më tepër, është pikërisht kjo situatë e cila përdoret si justifikim nga disa shtete anëtarë të BE-së për të pamundësuar liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, anipse Kosova ka arritur të plotësojë të gjitha kriteret e nevojshme në këtë proces. Përfundimisht, niveli i lartë i korrupsionit dhe krimin të organizuar dëmtojnë rëndë imazhin e Kosovës karshi bashkësisë ndërkombëtare dhe vlerësojnë Kosovën si vend pa prosperitet shoqëror, ekonomik e zhvillimor. Për të adresuar disa nga sfidat kyçe në këtë drejtim, GLPS i propozon qeverisë disa nga prioritetet kryesore si më poshtë:

- **Deklarimi i pasurisë dhe konfiskimi i pasurisë së pajustificueshme** – Deklarimi i duhur i pasurisë së zyrtarëve publik në Kosovë mbetet ende i mangët. Sipas Raporti të Vendi të KE-së, Agjencia Kundër Korrupsionit ende nuk ka mjete dhe burime për të verifikuar pasurinë e deklaruar nga zyrtarët publik. Duke konsideruar këtë, mbetet shumë e rëndësishme që qeveria e re të fuqizoj kapacitetet infrastrukturore dhe humane për të shënuar progres në këtë fushë. Për më tepër, Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet në fuqizimin e kapaciteteve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë, Administratës Tatimore të Kosovës, Policisë, Doganës, Njësitit të Inteligjencës Financiare dhe strukturave përkatëse lokale për të bashkërenduar përpjekjet në rritje të transparencës dhe llogaridhënies lidhur mbi asetet e deklaruar dhe ato që dështojnë të deklarohen.
 - Në të njëjtën linjë, Qeveria e Kosovës duhet të procedoj menjëherë me finalizimin dhe aprovimin e Projektligjit për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme në procedurë civile-penale, ashtu që çdo aset që nuk mund të justifikohet nga pala (barra e provës), i njëjti konfiskohet nga gjykata. Ky projektligj mbetet shumë i rëndësishëm në ngritjen e efikasitetit në luftim të krimin të organizuar dhe korrupsionit, duke mundësuar konfiskimin e të gjitha aseteve të fituara në mënyrë jo-ligjore.
 - Për të arritur rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, qeveria duhet që të përkushtohet seriozisht në promovim të veprimeve për implementimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ndër të tjera.
- IV. Një fushë tjetër e cila poashtu kërkon vëmendje të menjëhershme është financimi i partive politike në Kosovë. Me vite të tëra, organizatat e shoqërisë civile në Kosovë por edhe mekanizma të ndryshëm ndërkombëtar, përfshirë edhe Bashkimin Evropian, kanë avokuar për nevojën e domosdoshme për ngritje të transparencës dhe llogaridhënies sa i

përket financimit të partive politike në Kosovë.¹⁹ Në këtë drejtim, me ndihmën edhe të Komisionit të Venecias dhe shoqërisë civile, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është angazhuar në draftimin e Projektligjit për Financim të Partive Politike në Kosovë, i cili rregullon këtë fushë dhe nëse implementohet siç duhet, rrit ndjeshëm transparencën dhe llogaridhënien e partive politike. Ky projektligj u kalua në lexim të parë, por ngeci në Kuvend përshkak të rezistencës së partive politike për të mos përkrahur ligjin si të tillë, me arsyetime nga më të ndryshmet e kryesisht duke e klasifikuar si burokratik. GLPS konsideron që projektligji aktual i mbulon të gjitha fushat e nevojshme të rregullimit të financimit të partive politike, dhe çfarë është më e rëndësishmja, ofron standarde të larta dhe të implementueshme sa i përket rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së partive politike. Në këtë drejtim, GLPS rekomandon Qeverinë e Kosovës që të shtyj përpara këtë projektligj, dhe që i njëjti të miratohet në Kuvendin e Kosovës, pa ndryshime dhe në verzionin e tij origjinal. Një aspekt shumë i rëndësishëm lidhur me llogaridhënien e partive politike është auditimi i shpenzimeve financiare të të njëjtave. Në të kaluarën, ky proces ka qenë problematik, madje për një kohë të gjatë, financat e partive politike nuk janë audituar fare. Hera e fundit kur të njëjtat janë audituar në mënyrë konsekuative për 4 vite ka qenë në vitin 2017. Më pastaj, komisioni përkatës parlamentar ka dështuar të përzgjedh një auditor të ri për të ofruar këtë shërbim dhe sot jemi në situatë të njëjtë dhe problematike.²⁰ Mbetet shumë e rëndësishme që Kuvendi i Kosovës të alokoj buxhet të mjaftueshëm për t'u siguruar që kompani të ndryshme do kenë interes të ofertojnë për të ofruar një shërbim të tillë, dhe kjo gjë duhet bërë sa më parë duke konsideruar këtu edhe faktin edhe të zgjedhjeve të shpeshta dhe shpenzimeve të shumta për fushata elektorale.

V. Komunikimi me Bashkimin Evropian

Integrimi në Bashkimin Evropian mbetet perspektiva e vetme dhe e duhur për shtetin e Kosovës. Njësoj si vendet e tjera të rajonit, Kosova duhet të kaloj në disa procese dhe reforma të ndryshme, në mënyrë që të arrij standardet e kërkuara, por edhe t'i dëshmoj shteteve anëtare të BE-së se është e gatshme për t'iu bashkuar strukturave të tyre. Në këtë moment instrumenti më i rëndësishëm i Kosovës në këtë rrugë mbetet Marrëveshja për Stabilizim Asociim (MSA). MSA-ja është marrëveshja e parë kontraktuale, dhe momentalisht e vetmja, mes Kosovës dhe BE-së. Si e tillë, përfaqëson një instrument të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, komunitetin e biznesit, por edhe përmirëqenien e qytetarëve në përgjithësi. Në thelb, procesi i stabilizim asociimit ka përgatitur vendet e Ballkanit Perëndimor për t'i përafuar politikat e tyre me standardet e kërkuara nga BE, dhe për t'i përgatitur këto shtete për antarësim në familjen Evropiane. Me nënshkrimin e saj, BE-ja e ka vlerësuar pozitivisht Kosovën si të gatshme për prespektivën Evropiane, dhe si një shtet që synon të përqafoj mënyrat e BE-së në ekonomi dhe politikë. Zbatimi i duhur i saj mund të shfrytëzohet nga Kosova për të dërguar mesazh ndaj vendeve të BE-së, që Kosova është e gatshme për anëtarësim. Deri tani, implementimi i objektivave të paracaktuara me MSA i ka mundësuar vendit ndërmarrjen e hapave konkret drejt reformimit të ekonomisë, pra ka siguruar hapje graduale të ekonomisë me shtete anëtare të BE-së, por mbetet shumë punë për t'u bërë, në mënyrë që këto përfitime të jenë të prekshme. Përtej aspekteve tregtare, MSA-ja përfshin edhe reforma politike për forcim të demokracisë dhe

¹⁹ "Partitë politike nuk tregojnë shpenzimet e as burimet e financimit të fushatës zgjedhore", Kosova Press, Janar 2021. Linku: <https://kosovapress.com/glps-partite-politike-nuk-i-tregojne-shpenzimet-e-as-burimin-e-financimit-te-fushates-zgjedhore/>

²⁰ "Ska interesim për auditimin e financave të partive politike", Kallxo.com, Rr. Ramaj, 26 nëntor 2020. Linku: <https://kallxo.com/lajm/ska-interesim-per-auditimin-e-financave-te-partive-politike/>

sundimit të ligjit, të cilat janë reforma të mbështetura me fonde, me këshilla dhe bashkëpunim me insitucionet e BE-së. Për dallim nga vendet e tjera të rajonit, Kosova mbetet e fundit në rrugën drejt integritit Evropian, dhe kjo si pasojë kryekëput e mungesës së vullnetit institucional dhe politik për të çuar përpara reformat shumë të rëndësishme të cilat e përgatisin Kosovën për t'u bërë pjesë e këtij entiteti. Kjo bëhet edhe më e vështirë tani që BE-ja ka hartuar një Strategji të Re Zgjerimi, e cila ndër të tjera, përfshin edhe kushte më të ashpra për antarësim. Prandaj, Qeveria e Kosovës nuk ka kohë për të humbur në këtë drejtim, dhe plani i qeverisë duhet të ketë për bazë procesin e integritit në mënyrë horizontale dhe ndër-sektoriale. Përfundimisht, GLPS konsideron që qeveria duhet të ketë për bazë së paku disa nga objektivat kryesore si më poshtë:

Objektiva 1 – Zbatimi i Agjendës për Reforma Evropiane (ERA) dhe Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA (PKZMSA) – Për të implementuar MSA-në, në vitin 2017, qeveria e atëhershme hartoi dhe miratoi Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (2017-2021)²¹, i cili shërben si plan zbatues pesë vjeçar për objektivat dhe masat e kërkuara nga MSA-ja. Për të përshpejtuar tutje implementimin e kësaj marrëveshjeje, me iniciativën e atëhershme të Komisionerit Hahn, u draftua edhe Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) e cila është në parim një dokument më i fokusuar dhe me prioritetet e masa afatmesme dhe afatshkurtëra, e bartur në nivelin më të lartë politik. GLPS ka monitoruar vazhdimisht implementimin si të PKZMSA-së ashtu edhe të ERA-së, dhe ndër vite, është raportuar për progres të ulët të zbatimit të të dyja këtyre planeve strategjike.²² Kjo nënkupton që tërë këto vite ka munguar një koordinim ndër-institucional i mirëfilltë, e më e rëndësishmja, ka munguar vullneti politik për t'u angazhuar në zbatim të tyre. Konsideruar këtë, GLPS kërkon nga qeveria që të angazhohet menjëherë në dy rrafshet. Së pari, qeveria duhet që sa më parë të miratoj planin e veprimit të ERA II e cila ka mbet peng i votimit në qeverinë e kaluar. Por ERA II nuk duhet aprovuar në mënyrë unilaterale. Është shumë e rëndësishme, madje parakusht, që ERA II të aprovohet në formën e saj origjinale në kuptimin e dakordimit me Komisionerin për Zgjerim, dhe asesi siç është tentuar nga qeveritë paraprake. Së dyti, përmes ministrisë apo departamentit përkatës, qeveria duhet të angazhohet seriozisht në zbatimin e PKZMSA-së (2020-2024)²³ dhe të koordinoj punën e institucioneve përgjegjëse për zbatim të masave dhe objektivave të paracaktuara me këtë plan strategjik. Si ERA ashtu edhe PKZMSA, mbesin dy procese shumë të rëndësishme përmes të të cilave Kosova dëshmon vullnetin dhe gatishmërinë për rrugën e saj integruese.

Objektiva 2: Kontakti me Parlamentin Evropian – Një dialog i strukturuar dhe i mirëfilltë me Parlamentin Evropian duhet të jetë epiqendra e marrëdhënieve të Qeverisë së Kosovës me Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim, qeveria duhet të krijoj struktura qeveritare kompetente të cilat do angazhohen në ndërtimin e këtij dialogu tepër të nevojshëm me shtetet anëtare të BE-së. Kjo pastaj bëhet edhe më e rëndësishme në raport me pesë shtetet mosnjohëse, por edhe ato shtete të cilat kanë njohur shtetësinë por kanë shpërfaqur skepticizëm të shtuar ndaj të ardhmës Evropiane të vendit. Në të njëjtën linjë, Kosova duhet të angazhohet më intenzivisht në implementimin e Kapitullit 2 të MSA-së i cili ka për qëllim ndërtimin e një dialogu të mirëfilltë politik mes të dy palëve, me qëllim të arritjes së konvergencës në politikën e jashtme, dhe kjo do

²¹ "Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së", Qeveria e Republikës së Kosovës. Linku: http://mei-ks.net/repository/docs/1_pkzmsa_miratuar nga_kuvendi_final_.pdf

²² "GLPS: Ngecje e Kosovës në Planin për MSA-në", Kallxo.com, 04 shtator 2017. Linku: <https://bit.ly/3uyHNfy>

²³ "Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së StabilizimAsociimit (PKZMSA) 2020 – 2024", Qeveria e Republikës së Kosovës. Linku: <https://bit.ly/3ftv1UL>

arrihej përmes një angazhimi konkrete të politikës së jashtme të Kosovës me Shërbimin e Jashtëm Diplomatik të BE-së (EEAS).

Objektiva 3 – Liberalizimi i vizave – Kosova tashmë sa vite ka plotësuar të gjitha kriteret e nevojshme për liberalizim të vizave²⁴, e të cilat kanë qenë dyfishi i atyre që i janë kërkuar vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Pavarësisht kësaj, Kosova ende vazhdon të mbetet vendi i vetëm i izoluar në mesin e rajonit. Edhe pse Parlamenti Evropian sapo ka mbështetur liberalizimin e vizave për Kosovën për të disatën herë, procesi mbetet ende pezull i Këshillit të BE-së, përkatësisht, ministrave të brendshëm të vendeve anëtare për të dhënë dritën e gjelbër. Viteve të fundit është parë një skepticizëm i shtuar nga Franca për të mos përkrahur këtë proces, pavarësisht që Kosova ka treguar hapa konkret në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe një gjë e tillë është evidentuar edhe nga vet Bashkimi Evropian. Duke konsideruar këto më lartë, GLPS konsideron që mbetet shumë e rëndësishme që Qeveria e Kosovës të hartoj një strategji për të lobuar karshi shteteve skeptike dhe të bind këto shtete se Kosova në fakt ka plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara dhe nuk ekziston ndonjë arsye valide për të mos u aprovuar një proces i tillë. Për të bërë këtë, Qeveria e Kosovës duhet të dialogoj intensivisht me këto shtete dhe të gjej modalitete për të ndryshuar perceptimin e tyre karshi Kosovës.

Objektiva 3 – Njohja nga pesë shtetet anëtare të BE-së – Pos çështjeve të brendshme për përafrim me BE-në, Kosova duhet të tregoj kujdes të shtuar edhe sa i përket mungesës së njohjes zyrtare nga 5 shtete anëtare të BE-së që përfshijnë Greqinë, Sllovakinë, Qipron, Rumaninë dhe Spanjën. Deri më tani, asnjë progres nuk është shënuar në këtë drejtim dhe qeveritë e deritanishme nuk kanë pas një strategji të qartë se si ti qasen këtyre vendeve. GLPS konsideron se mbetet shumë e rëndësishme që Qeveria e Kosovës t'a merr me seriozitet të shtuar fillimin e ndërtimit të marrëdhënieve dhe dialogut të shëndosh me këto shtete, me qëllim final njohjen e shtetësisë së Kosovës. Pa njohjen e këtyre shteteve, rruga e integritit Evropian do jetë e vështirë dhe me shumë sfida.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm i rrugës integruese të Kosovës mbetet edhe **Reforma në Administratë Publike**, një proces shumë kompleks dhe me mbështetje të madhe nga Bashkimi Evropian. Qeverisja e mirë dhe një administratë profesionale dhe efikase mbesin thelbi i procesit të integritit Evropian. Kosova është zotuar të punoj për të arritur një administratë publike jo të politizuar, efikase, transparente dhe me shërbime sa më të mira për qytetarët e saj. Ndër vite, me ndihmën edhe të SIGMA/OECD, Kosova ka arritur të përcaktoj gjashtë fusha kryesore të kësaj reforme, përfshirë kornizën strategjike të reformës në administratë publike, koordinimin dhe zhvillimin e politikave, shërbimet publike dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, llogaridhënien, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e financave publike. GLPS konsideron se kjo reformë mbetet ndër iniciativat më të rëndësishme të Kosovës, në dy aspekte. Së pari, në aspektin e brendshëm, mundëson ofrimin e shërbimeve më cilësore nga një administratë profesionale dhe transparente. Së dyti, në aspektin e jashtëm, i mundëson vendit përmbushjen e standardeve konform kërkesave të BE-së. Megjithatë, Kosova ende nuk ka arritur të shënoj progres të dëshiruar sa i përket kësaj reforme. Sipas raportit të fundit për Vendin të Komisionit Evropian, Kosova ka shënuar progres të limituar sa i përket reformës në administratë publike, duke i vënë theks të veçantë ngecjes të implementimit të pakos ligjore të miratuar në vitin 2019,

²⁴Komisioni Evropian propozon heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës, Komunikatë për shtyp, Komisioni Evropian, 4 maj 2016. Linku: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/sq/IP_16_1626

përkatësisht, tri ligjeve kryesore që rregullojnë sektorin publik.²⁵ Tutje, raporti thekson se ndikimi politik në rekrutim të pozitive të larta zyrtare dhe i pa bazuar në meritë ka ndikuar dukshëm në rritjen e mungesës së besimit qytetar karshi administratës publike. GLPS konsideron që Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet në këto objektiva kyçe si më poshtë:

Objektiva 1 – Miratimi i Ligjit për Qeverinë – Ndër vite, Kosova është karakterizuar me numrin më të madh të ministrive, zëvendës ministrave e këshilltarëve në të gjithë rajonin. Për më tepër, edhe punësimet në administratë publike, në të shumtën e rasteve, janë bërë mbi premisa politike dhe jo-meritore. Madje, administrata publike me vite është konsideruar si punëdhënësi më i madh në vend, e që është koncept krejtësisht i gabuar. Për t'a thelluar tutje këtë problem serioz, çdo qeveri e re që është krijuar ka rritur numrin e dikastereve ministrore dhe stafit përkatës, sipas nevojave të tyre politike, e shpeshherë për të rehatuar militant partiak dhe persona me lidhje të ngushtë. Për t'i mënjanuar këto sfida dhe për të siguruar një përbërje optimale të qeverisë, GLPS konsideron se mbetet shumë e rëndësishme që Qeveria e Kosovës të përshpejtoj procesin e miratimit të Ligjit për Qeverinë. Ky ligj rregullon përbërjen qeveritare, duke përfshirë këtu numrin e ministrive, zëvendës ministrave, Zyrës së Kryeministrit, si dhe aspekte të tjera po aq të rëndësishme mbi strukturën qeveritare. Ndër të tjera, ky ligj shpërndan kompetencën gjatë formimit të qeverisë, dhe i jep Kuvendit të Kosovës një rol të shtuar gjatë themelimit të institucioneve qeveritare dhe nuk e lë një gjë të tillë vetëm mbi mandatarin e qeverisë përkatëse. Ky ligj duhet miratuar mbi bazën e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Venecias dhe organizatat e shoqërisë civile në Kosovë.

Objektiva 2 - Ristrukturimi i Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura - Me Ligjin e ri për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (nga këtu: LOFASHAP) është krijuar baza ligjore për organizimin dhe funksionalizimin tyre, mirëpo sfida ka mbetur zbatimi i tij në praktikë. Nën këtë objektivë, GLPS i propozon qeverisë këto veprime:

- Përfundimi i ristrukturimit të Qeverisë dhe ministrive, proces i cili ka filluar që gati një vit dhe i cili ende nuk është funksionalizuar në tërësi;
- Racionalizmi i agjencive ekzekutive, rregullatore dhe të pavarura në pajtim me nenin 53 paragrafi 1 i LOFASHAP;
- Organizimi i brendshëm i administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura përfshirë edhe pjesën e klasifikimit të vendeve të punës. Ky proces duhet të realizohet sipas ligjit të lartpërmendur, në aspektin e ndarjes së përgjegjësive sidomos në mes të ministrisë, agjencisë dhe administratave të shërbimeve publike;
- Hartimi i planeve të performancës për agjencitë ekzekutive, sipas nenit 30 të LOFASHAP dhe vlerësimi i performancës së tyre.

Objektiva 3 - Reforma në Shërbimin Publik (Civil) - Ligji i ri për zyrtarët publike (LZP) ka vendosur një bazë të mirë për vazhdimin e reformave në shërbimin publik i cili karakterizohet si për nga gjithëpërfshirja ashtu edhe për nga materia që rregullon, e të cilat janë në pajtim të plotë me parimet e SIGMA/OECD për administratën publike. Meqenëse ky ligj është shpallur i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese në raport me 8 institucione kushtetuese, është nevojë urgjente që i njëjti të plotësohet dhe ndryshohet në pajtim me Aktgjykimin nr. KO203/19 të kësaj Gjykate. Njëjtë si LOFASHAP edhe ky ligj po sfidohet në zbatimin në praktikë prandaj si veprime të nevojshme propozohen:

²⁵Raporti për Vëndin i Komisionit Evropian (fq.13), Tetor 2020. Linku: <https://bit.ly/3fTiHbk>

- Plotësimi dhe ndryshimi i LZP sipas Aktgjykimit nr. KO203/19 të GJK sa më shpejt që është e mundur (afati ka qenë 3 muaj pas publikimit të aktgjykimit dhe i njeiti ka kaluar qysh në tetor të vitit 2020);
- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për nëpunësit e shërbimeve publike (arsim, shëndetësi dhe kulturë) dhe ata teknik dhe mbështetës;
- Funksionalizimi i plotë i Departamentit për Zyrtarët Publik;
- Funksionalizimi i sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore (SUMBNJ);
- Përfundimi i procesit të klasifikimi të vendeve të punës të nëpunësve civil;
- Fillimi i zbatimit të sistemit të rekrutimit në grupe në administratë shtetërore dhe institucione tjera;
- Plotësimi i vendeve të rregullta të punës në nivelin e lartë drejtues sipas parimit të meritës (aktualisht shumica e këtyre pozitave ushtrohen me zëvendësues);
- Hartimi dhe miratimi i Ligjit të Pagave në pajtim me aktgjykimin nr. KO219/19;
- Publikimi i të gjitha pagave dhe shtesave tjera në pagë, në baza mujore, duke ruajtur të dhënat personale sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Objektiva 4 - Reforma e shërbimeve publike administrative dhe E-Qeveria - Një qeveri e hapur (Open Government) dhe digjitalizimi i shërbimeve (E-governance) duhet të jenë prioritetet kyçe për qeverinë. GLPS propozon që ky proces të realizohet në tri faza. E para, përmes ndryshimeve ligjore në kuptim të reduktimit të rregullimit të procedurave të veçanta administrative dhe harmonizimit të tyre me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) kur të njejtat janë të justifikueshme të ekzistojnë. Kjo mund të realizohet përmes një ligji që i plotëson dhe ndryshon të gjitha ligjet e veçanta. E dyta, duke ndryshuar praktikën burokratike dhe për të cilat nuk nevojitet të bëhen ndryshime ligjore. E treta, përmes digjitalizimit të shërbimeve publike administrative dhe funksionalizimit të mirëfillt të E-Qeveria. Meqenëse ka pasur shumë iniciativa edhe më herët por të cilat kanë dështuar, te kjo objektivë duhet të merren parasysh këto elemente:

- Të vendoset baza ligjore, përkatësisht, të miratohet sa më shpejt projektligji për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike, si parakusht për digjitalizimin e shërbimeve;
- Digjitalizimi të filloj me shërbimet administrative të cilat nuk kanë nevojë të optimalizohen dhe harmonizohen me LPPA;
- Digjitalizimi të bëhet për shërbimet të cilat janë më të frekuentuara dhe zbatohet në faza.

VI. Politika e Jashtme dhe Dialogu me Serbinë

Në tërë këto vite të pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ende nuk ka një strategji të qartë mbi konsolidimin e metutjeshëm të shtetësisë në arenën ndërkombëtare, dhe vazhdon të ketë një numër të njëjtë njohjesh tash e sa vite, madje në disa raste edhe njohje të tërhequra. Risia e vetme në këtë drejtim është njohja shumë e rëndësishme nga Izraeli,²⁶si pjesë e marrëveshjes së 4 shtatorit të nënshkruar në Washington. Për më tepër, Kosova ka dështuar që të ndal fushatën e vazhdueshme të Serbisë për mosnjohje të shtetësisë së Kosovës, e cila jo pak herë ka rezultuar me sukses. Me lartë kemi përmendur edhe mosnjohjen nga 5 shtetet anëtare të BE-së, e cila poashtu konsiderohet si dështim i politikës së jashtme të Kosovës për të arritur të ndërtohet çfarëdo marrëdhënie me këto shtete. Shqetësim i njëjtë mbetet edhe mungesa e një strategjie të mirëfilltë për të konsoliduar marrëdhëniet me shtetet që tashmë kanë njohur pavarësinë e vendit, e sidomos me ato shtete që kanë njohur pavarësinë por më vonë janë evidentuar shumë skeptike për një vendim të tillë. Me saktësisht, tërë këto vite, diplomacia kosovare nuk ka arritur të krijoj marrëdhënie të rregullta dhe të shëndosha me shumë nga këto shtete skeptike, sikurse janë Polonia, Republika Çeke, etj. Për më tepër, institucionet tona nuk kanë arritur të shfrytëzojnë përkrahjen e shteteve mike sikurse SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, etj të bindin shtete të tjera për të sjell njohje të reja. Kosova lëre që nuk ka ndonjë të arritur të theksuar në rrafshin diplomatik, por madje ka shënuar edhe regres duke u dakorduar për një moratorium një vjeçar për anëtarësim në mekanizma ndërkombëtar dhe sjelljen e njohjeve të reja.²⁷ Poashtu, dështimi për t'u anëtarësuar në UNESCO, Interpol, dhe organizata të tjera ndërkombëtare që legjitimojnë tutje shtetësinë e Kosovës është evident dhe kërkon vëmendje të menjëhershme. Në këtë drejtim, GLPS i propozon qeverisë disa nga objektivat kyçe si më poshtë:

Objektiva 1: Ristrukturimi i brendshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD)

–GLPS konsideron se Qeveria e Kosovës duhet të ketë prioritet fuzionimin adekuat të tashmë MPJD-së, duke inkorporuar në mënyrë të duhur dhe efikase edhe prioritetet strategjike të ish Ministrisë së Diasporës. Në të njëjtën kohë, MPJD duhet të i nënshtrohet një riskstrukturimi të brendshëm në mënyrë që të mos ketë mbivendosje të kompetencave brenda departamenteve të ndryshme, dhe të ketë një ndarje të qarte hierarike brenda institucionit.

Objektiva 2: Rishikimi dhe rivlerësimi i Shërbimit të Jashtëm Diplomatik (Vetingu ne Diplomaci) –

Shfrytëzimi i Shërbimit të Jashtëm Diplomatik për të akomoduar militantë partiak e me interesa të ngushta politike ka dëmtuar rëndë imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Rekrutimet jo-meritore, në baza nepotizimi dhe të ndërhyrjes së vazhdueshme politike kanë bërë që diplomacia e Kosovës të stërbushet me persona jo-kompetent, dhe shpeshherë, me mungesë të integritetit dhe profesionalizimit. Duke konsideruar gjendjen aktuale në këtë fushë, GLPS vlerëson që Qeveria e Kosovës duhet që menjëherë të ndërmarr veprime serioze për të filluar reformimin e Shërbimit të Jashtëm Diplomatik dhe rritjen e efektivitetit të politikës së jashtme në përgjithësi. Për ta bërë këtë, ne propozojmë disa veprime si në vijim:

- Qeveria e Kosovës duhet të ndaloj çdo proces të ri rekrutues me qëllim të rivlerësimit të situatës aktuale në shërbimin diplomatik në mënyrë që të identifikohen problemet

²⁶ “Kosova hap zyrtarisht ambasadën e saj në Jerusalem”, DeutcheWelle, B. Shehu, 15 mars 2021. Linku: <https://bit.ly/3mzuEAK>

²⁷ “Çfarë përmban marrëveshja e nënshkruar në Uashington?”, Evropa e Lirë, 04 shtator 2020. Linku: <https://bit.ly/3msmXeY>

dhe nevojat që mund të dalin nga ky vlerësim i tërthortë i MPJD-së. Për tu arritur ky qëllim, qeveria duhet të bëjë një analizë të thellë mbi stafin aktual në të gjitha misionet diplomatike, përgatitjen e tyre profesionale, të arriturat, ligjshmërinë e procesit të emërimit të tyre nga qeveritë paraprake, nevojat profesionale dhe performancën e deritanishme. Në këtë mënyrë, qeveria do arrij të ketë një pasqyrë të qartë mbi kualitetin e shërbimit diplomatik të jashtëm dhe të identifikoj fushat ku kërkohet ndërhyrje e menjëhershme;

- Ngjashëm, qeveria duhet të angazhohet në rishikimin e të gjitha gradave diplomatike dhe këtë duhet ta bëj në disa faza. Fillimisht, qeveria duhet të analizoj nëse procesi i fitimit të gradave diplomatike është bërë në mënyrë meritore. Nëse një gjë e tillë nuk ka ndodhur, atëherë çdo i emëruar pa meritë duhet të rikthehet në vend. Për të vlerësuar ligjshmërinë e gradimit, qeveria duhet të ketë përbazë vendimet paraprake të Komisionit të Vlerësimit të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për ta ndërmarrë një vendim të tillë.

Objektiva 3: Zhvillimi i një diplomacie proaktive multilaterale – Qeveria e Kosovës duhet të marr një qasje proaktive dhe të ndërmarrë hapat e duhur për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare siç janë Këshilli i Evropës, Interpol dhe UNESCO. Për më tepër, Kosova duhet të synojë anëtarësimin edhe në Fondin për Zhvillimin Bujqësor dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë meqenëse kriteret janë më të kalueshme në krahasim me mekanizma të tjerë ndërkombëtarë. Këto procese mund të zgjasin me vite, por një ekip adekuat me një strategji të qartë të lobimit mund të arrijnë të tregojnë sukses në këtë drejtim.

Objektiva 4: Fuqizimi i diplomacisë bilaterale - Qeveria fillimisht duhet të përqendrohet në mbajtjen e marrëdhënieve të duhura me shtetet që e kanë njohur Kosovën. Më saktësisht, qeveria duhet të punoj në mirëmbajtjen e marrëdhënieve diplomatike me këto vende, dhe të mos konsiderohen si të mirëqena ashtu siç u konsideruan nga qeveritë e deritanishme. Reflektim i kësaj është edhe dështimi në procesin e anëtarësimit në UNESCO në vitin 2015. Shtete të tilla si Polonia, që njohin Kosovën, abstenuan në procedurën e votimit të anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë dhe kjo kryekëput përshkak të mos kultivimit të marrëdhënieve adekuate. Për këtë arsye, mirëmbajtja e duhur diplomatike dhe përfaqësimi i Kosovës në shtetet që e kanë njohur atë duhet të jetë në nivelin e duhur diplomatik. Definitivisht, GLPS konsideron se qëllim afatgjatë i qeverisë duhet të jetë anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB).

Objektiva 5: Të rishikohet Ligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës – Legjislacioni aktual për Shërbimin e Jashtëm, së bashku me rregulloret dhe udhëzimet e tjera administrative, mundëson manovrimin me pozicionet diplomatike për favore politike dhe praktika klienteliste, si dhe mundëson abuzime të mundshme me procese të rekrutimit. Për më tepër, procesi i ndryshimit dhe plotësimit të legjislacionit për Shërbimin e Jashtëm i vitit 2010 është treguar joproduktiv. Një numër i caktuar i neneve në këtë legjislacion janë në konflikt të brendshëm pasi kundërshtojnë njëra-tjetrën, dhe disa nene fuqizojnë politizimin e Shërbimit të Jashtëm duke autorizuar emërimet të personave pa grada diplomatike dhe konsullore. Kështuqë, pothuajse çdo qeveri në Kosovë ka përfituar nga këto boshllëqe legjislative dhe ka përdorur fuqinë e saj për të sistemuar anëtarët partiak në misionet diplomatike të vendit. Duke konsideruar të gjitha këto, GLPS konsideron shumë të nevojshme që Qeveria e Kosovës të rishikoj këtë ligj, duke e bërë atë më të ashpër dhe të zhveshur nga të gjitha nenet të cilat ofrojnë hapësirë për manovrimet të tilla të abuzimit, qoftë me pozita diplomatike poashtu edhe gjatë proceseve të rekrutimit.

Në sferën e politikës së jashtme, **Dialogu me Serbinë** mbetet ndër çështjet kryesore dhe duhet të trajtohet me seriozitetin më të lartë nga Qeveria e Kosovës. Përpos që është kërkesë ndërkombëtare dialogu është edhe përgjegjësi shtetërore. Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë me njohje juridike të rezervave dhe vendosje të marrëdhënieve diplomatike është qëllim final i institucioneve të Kosovës për kompletimin e shtetësisë së saj. Andaj, veprimi i qeverisë së re dhe çdo përfaqësuesi politik duhet të jetë në funksion të këtij qëllimi. Qeveria e Kosovës dhe përfaqësuesit më të lartë politik të shtetit duhet të kërkojnë që BE dhe SHBA të jenë prijëtare bashkërisht të dialogut, e jo që Kosova të shndërrohet në një instrument përçarës ndërmjet tyre. Lidhur me këtë proces, GLPS konsideron që qeveria duhet të ketë parasysh disa elemente si më poshtë:

- Qeveria e Kosovës duhet të përpilojë një platformë shtetërore mbi dialogun që përcakton parimet, objektivat dhe temat e bisedimeve. Platforma shtetërore duhet të jetë pasqyrim i pikëpamjeve të të gjitha partive politike parlamentare, dhe konsultimet shtesë me akterë të tjerë publik si akademia dhe shoqëria civile janë vlerë e shtuar për Kosovën. Konsensusi i përgjithshëm politik duhet t'i paraprijë marrëveshjes finale. Pajtueshmëria e gjerë politike mbi çështje të Dialogut është kriter i patejkalueshëm. Pavarësisht fuqisë së Qeverisë së re në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ajo duhet të insistojë në bashkëpunim ndërpartiak duke ofruar infrastrukturën e duhur për përfshirje përmbajtësore të opozitës parlamentare në procesin e Dialogut. Kjo duhet të bëhet për dy arsye: E para sepse dialogu nuk është një çështje e zakonshme politike, por është përcaktues për të ardhmën e Kosovës dhe konsolidimit të shtetësisë së saj; dhe përgjatë dialogut Kosova mund të përballet me tema jo të lehta e kërkesa për kompromise për të cilat duhet një përgjigje konsensuale politike.
- Marrëveshja finale me Serbinë duhet të jetë në përputhje me shtetësinë e saj të shpallur më 2008. Qeveria duhet të sigurohet që marrëveshja të realizohet në bazë të dy vijave të kuqe. Nën 1, Territori i Republikës së Kosovës nuk mund të bëhet objekt i negociimit, të çfarëdolloji, në Dialogun Kosovë Serbi. Një ndalesë e tillë nuk është vetëm premisë kushtetuese por edhe një precedent i rrezikshëm për karakterin e Republikës së Kosovës; dhe nën 2 monoetnizimi i institucioneve mbi çfarëdo baze nuk duhet të jetë pjesë e dialogut, dhe duhet të qartësohet se kjo nuk bëhet për çështje diskriminimi për ndonjë entitet në Kosovë, por për shkaqe të funksionalitetit të shtetësisë. Qeveria e Kosovës duhet ta zhvillojë një dialog proaktiv dhe jo nga pozicioni defanziv dialogues ku Kosova detyrohet të zgjedh në mes të këqijave.

VII. Arsimi

Adresimi i sfidave dhe mungesës së shtuar të cilësisë në arsim mbetet një nga prioritetet kryesore që kërkojnë adresim të menjëhershëm. Se në çfarë gjendje të rënduar gjendet sektori i arsimit flasin edhe rezultatet e vazhdueshme të PISA, duke u ranguar në fund, dhe vetëm para Filipineve dhe Republikës Dominikane²⁸, por njësoj edhe vlerësimet nga raporte të ndryshme kredibile. Sipas raportit të fundit për vendin nga Komisioni Evropian, Kosova klasifikohet si një vend ende në faza fillestare të përgatitjes në fushën e arsimit. Madje, i njëjti vlerëson që tash e sa vite, Kosova nuk ka shënuar asnjë progres drejt përmirësimit të cilësisë në arsim, dhe atë në

²⁸ "Në thellësi, çfarë thonë rezultatet e testit PISA për Kosovën", Kallxo.com, D. Baraliu, A. Shefkju, 03 dhjetor 2019. Linku: <https://kallxo.com/arsim/ne-thellesi-çfare-thone-rezultatet-e-testit-pisa-per-kosoven/>

të gjitha nivelet.²⁹ Niveli i ulët dhe i mesëm i arsimit në Kosovë vazhdojnë ende të operojnë pa libra mësimor. Poashtu, disa herë, Kosova është larguar nga mekanizma ndërkombëtar siç janë ENCA dhe EQAR, e të cilat janë shumë të rëndësishme në kontrollin dhe rritjen e cilësisë në arsim, por edhe për njohje të shkollimit të përfunduar në Kosovë. Për më tepër, arsimi i lartë është karakterizuar vazhdimisht me nepotizëm, rekrutime jo-ligjore dhe shkelje të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. E kjo situatë ka ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e arsimit që ofrohet në universitetin publik. Në të njejtën kohë, edhe arsimi i lartë privat ka degraduar vazhdimisht në cilësi, dhe në shumë raste, është shëndërruar në një mënyrë të të bërit biznes sesa ofrimin të edukimit të duhur, duke qenë kështu pre e interesave private dhe politike. Sektori i arsimit, si edhe të gjithë sektorët e tjerë janë ndikuar rëndë nga pandemia COVID-19, e cila veç sa ka shpërfaqur më shumë të gjitha problemet me të cilat karakterizohet ky sektor dhe ky është një element tjetër poaq i rëndësishëm për t'u konsideruar gjatë implementimit të çfarëdo reforme në arsim. Duke konsideruar të gjitha këto, GLPS vlerëson që mbetet urgjente nevoja për nisjen e një reforme të mirëfilltë në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë. Në këtë drejtim, GLPS propozon disa objektiva kyçe si në vijim:

Objektiva 1: Transformimi i Universiteteve Regjionale: Qeveria e Kosovës duhet të rishikoj funksionimin e deritanishëm të universiteteve publike regjionale, dhe përfundimisht, të inicoj procesin e transformimit të këtyre degëve rajonale në universitete me programe profesionale (shembull në Gjermani: hochschule). Kjo do të ndihmonte që të zvogëlohej hendeku i madh që ekziston mes kërkesës dhe ofertës aktuale në tregun e punës. Në të njejtën kohë, një reformë e tillë do të siguronte aftësimin profesional të të rinjve duke i përgatitur ata për kërkesat në tregun e punës.

Objektiva 2: Fuqizimi i shkollave profesionale dhe aftësimi profesional – Kosova karakterizohet me një popullsi të re ne moshë dhe të gatshme për t'iu bashkuar tregut të punës. Ngjashëm, mbetet një nga vendet e Evropës me më së shumti studentë në relacion me numrin e popullsisë. Megjithatë, ka një hendek të madh mes nevojave të punëkërkesve dhe asaj çfarë ofrohet në tregun e punës. Kjo si pasojë kryekëput e mbipopullimit të universiteteve publike e private në disa drejtime në veçanti, duke e bërë ofertën në treg të varfër dhe të kufizuar vetëm në disa profesione kryesisht të shkencave sociale. Më saktësisht, qeveritë paraprake nuk kanë bërë asnjëherë një analizë të thellë mbi atë se çfarë i nevojitet tregut të punës dhe pastaj të fuqizojnë edhe degët e edukimit edhe konform këtyre nevojave. Shkollat profesionale në Kosovë tashmë e sa kohë kanë mbetur nën hije dhe qeveritë paraprake nuk kanë dëshmuar aspak vullnet që të fokusohen në ngritjen e kapaciteteve sa i përket aftësimin profesional, me qëllim të fundit zbutjen e hendekut mes ofertës dhe kërkesës në tregun e punës në Kosovë. Një qasje e tillë natyrisht që do ndikonte direkt edhe në uljen e papunësisë duke diversifikuar kështu mundësitë që i ipen të rinjve por edhe sektorit privat për të absorbuar persona me aftësi adekuate për një pozitë pune të caktuar. Përfundimisht, GLPS konsideron që Qeveria e Kosovës duhet të prioritetizoj investimin në shkollat profesionale në Kosovë të cilat momentalisht ballafaqohen me probleme thelbësore siç është mungesa e materialeve mësimore, teksteve shkollore dhe infrastrukturës së duhur. Poashtu, GLPS vlerëson që qeveria duhet të angazhohet të krijoj një dialog profesional mes shkollave profesionale dhe sektorit privat, për të arritur kështu të krijohet një urë lidhëse mes asaj çfarë ofrohet në tregun e punës dhe kërkesave të kompanive dhe punëdhënsit.

²⁹ Raporti për Vendin i Komisionit Evropian (fq.83), Tetor 2020. Linku: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

Objektiva 3: Miratimi i Ligjit të ri për Arsimin e Lartë – Kosova ende nuk ka miratuar ligjin e ri që rregullon arsimin e lartë në vend. Qëllimi i këtij ligji është të fuqizoj autonominë e institucioneve dhe të sigurojë përmirësimin e cilësisë dhe të integritetit akademik. Mungesa e këtyre elementeve ka shkaktuar përjashtimin e Kosovës nga mekanizma të rëndësishëm ndërkombëtar dhe një gjë e tillë duhet të evitohet me çdo kusht në të ardhmën. Përfundimisht, Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet që sa më parë ta miratoj këtë ligj dhe të vë atë në funksion në praktikë.

Objektiva 4: Riantarësimi në Shoqatën Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) – Qeveria e Kosovës duhet, që gjatë vitit të parë në qeverisje, të synoj riantarësimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit në ENQA. Ky antarësimi i'u revokua Kosovës në vitin 2019 përshkak të ndërhyrje të atëhershme politike në Agjenci, duke klasifikuar kështu vendin tonë si jo të denjë t'iu përmbahet rregullave dhe standardeve të ENQA-së. Duke qenë qëviti 2021 e bën Kosovën përsëri të pranueshme në ENQA (sepse në rast përjashtimi nuk mund të aplikosh për 2 vite), shteti ynë duhet të nis menjëherë riaplikimin në këtë mekanizëm, por jo vetëm. Për arritur këtë, Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet drejt fuqizimit të kapaciteteve të Agjencisë për Akreditim dhe të siguroj pavarësi të plotë për këtë institucion.

Objektiva 5: Investim i qëndrueshëm në zhvillimin e mëtutjeshëm profesional të personelit arsimor në Kosovë - GLPS konsideron që për të ngritur cilësinë në arsim, qeveria duhet të angazhohet në vazhdimësi të ngris kapacitetet profesionale te personelit arsimor në të gjitha nivelet. Zhvillimi i mëtutjeshëm profesional nuk duhet kufizuar në trajnime konvencionale por duhet marr metoda moderne të shteteve të zhvilluara dhe të hartohet një plan konkret dhe modern në këtë drejtim. Pandemia COVID-19 na mësoi se sa i rëndësishëm është digjitalizimi, përkatësisht, ngritja e kapaciteteve profesionale përmes metodave online. Në Kosovë u pa që përgatitja profesionale e personelit arsimor në këtë aspekt është shumë e mangët dhe kjo tregoi që metodat e deritanishme të komunikimit në mes të stafit arsimor, nxënësve dhe prindërve kanë qenë jashtëzakonisht të kufizuara dhe duke mos shfrytëzuar metodat online, sikurse në vende të zhvilluara të botës. Kjo krijoi shumë sfida gjatë kohës së mësimnxënies online, të cilat janë ende prezente. Duke konsideruar këtë, krahas zhvillimit të mëtutjeshëm të kapaciteteve profesionale, një ngritje e aftësive të personelit arsimor në përdorimin e mjeteve teknologjike mbetet thelbësore, në mënyrë që të diversifikohen dhe përmirësohen metodat e komunikimit. Edhe po të mos kishim situatën me pandemi, qeveria gjithsesi do duhej që të ndërmerre hapa konkret për të instaluar metodat digjitale të komunikimit.

Objektiva 6: Rritja e buxhetit për sektorin e arsimit – Në mënyrë që të arrihen përmirësime të dukshme në këtë sektor, Qeveria e Kosovës duhet të konsideroj rritje të menjëhershme të mjeteve buxhetore në mënyrë që të jetësohet ideja e reformimit të thellë në arsim, e cila mbetet jashtëzakonisht e rëndësishme, dhe e vetmja mënyrë për të përmirësuar situatën aktuale. Për ta bërë këtë, GLPS i propozon qeverisë të bëjë një analizë të thellë të gjendjes në arsim duke përfshirë këtu edhe pasojat që ka shkaktuar COVID-19, dhe kështu të identifikoj çështjet prioritare në arsim që i duhen nënshtruar kësaj reforme. Konfrom kësaj analize, qeveria duhet të hartoj edhe një plan veprimi që përfshin edhe implikimet buxhetore, në mënyrë që të ipet një pasqyrë e qartë e nevojave reformuese dhe buxhetore në këtë sektor. Kjo do të rezultonte me një strategji të mirëfilltë veprimi, e cila në afatgjatë, ka për qëllim përmirësimin e të gjitha niveleve të edukimit në Kosovë. Duke konsideruar të gjitha këto më lartë, GLPS vlerëson që buxheti për arsimin duhet së paku të dyfishohet.

VIII. Mjedisi

Një fokus i veçantë poashtu duhet të vendoset tek mbrojtja e mjedisit. Ndër vite, Kosova është ballafaquar me degradim të vazhdueshëm të mjedisit, pa një ndërhyrje të mirëfilltë nga institucionet shtetërore të thirrura në këtë drejtim. Madje, në shumë raste kanë qënë pikërisht po këto institucione të cilat kanë mundësuar shkatërrimin e mëtutjeshëm të ambientit, duke mundësuar ndërtimin e hidrocentraleve të ndryshme, autostradave, dhe objekteve banuese e afariste në toka pjellore e vende të mbrojtura me ligj, përmes dhënies së lejeve jo-ligjore. Për më tepër, Kosova vazhdon të rangohet ndër shtetet me cilësinë e ajrit më të dobët në botë, e madje në shumë raste rangohet edhe në vendin e parë. Kjo duhet parë me një shqetësim shumë të madh nga qeveria, dhe intervenimi i menjëhershëm mbetet i domosdoshëm. Njësoj, edhe Raporti për Vendin i BE-së vlerëson se Kosova nuk ka shënuar fare progres në këtë drejtim dhe se nevojitet një vullnet i shtuar politik për të adresuar degradimin e ambientit si dhe sfidat që vijnë si pasojë e ngrohjes globale.³⁰

Objektiva 1: Të angazhohet në miratimin dhe implementimin e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë: Qeveria e Kosovës duhet që të miratoj dhe nis implementimin e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë sa më parë që është e mundur. Ky plan duhet të jetë në harmoni të plotë me Marrëveshjen e Gjelbërt për Ballkanin Perëndimor të lansuar nga Bashkimi Evropian së fundmi,³¹dhe të nënshkruar në Samitin e Sofjes. Në të njejtën kohë, qeveria duhet që të angazhohet në implementim e strategjisë aktuale për mjedis (2011 – 2021) për kohën e mbetur të këtij viti, dhe paralelisht të angazhohet në rishikimin e saj dhe hartimin e verzionit të ri të kësaj strategjie. Paralelisht, ministria përkatëse duhet angazhuar që të implementoj një fushatë vetëdijësimi të vazhdueshme mbi rëndësinë e mbrojtjes së ambientit, nevojën për investim të shtuar në energji të ripërtrishme, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e resurseve ujore. Për fund, qeveria duhet angazhuar në vazhdimësi që të përgatis një plan për përafrim të këtyre standardeve me acquis të BE-së dhe të funksionoj në përputhje me kërkesat dhe standardet e BE-së për energji dhe klimë. Duhet rikujtuar që miratimi dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së mbi mjedisin është një detyrim që Kosova ka ndërmarrë me nënshkrim të MSA-së.

Objektiva 2: Kualiteti i Ajrit dhe Mbrojtja e Resurseve Ujore: Kualiteti i ajrit në Kosovë vazhdon të mbes një kërcënim i madh për shëndetin dhe cilësinë e jetës së qytetarëve në përgjithësi. Kosova tash e sa vite vazhdon të mbes ndër vendet me cilësinë më të ulët të ajrit në botë, e shpeshherë edhe i prin kësaj liste. Cilësia e dobët e ajrit vije si pasojë e termocentraleve të vjetëruara, ngrohjeve jo të duhura në amvisëri, trafikut të dendur, djegies së mbeturinave dhe materiale të tjera toksike, e deri tek emetimet industriale. Deri më tani, qeveritë kanë dështuar të ndërmarrin masa adekuate të cilat do të përmirësonin cilësinë e ajrit në Kosovë, gjë që do mund të bëhej përmes planeve konkrete. Në këtë drejtim, qeveria duhet të hartoj dhe implementoj një strategji të qartë veprimi i cili redukton përdorimin e qymyrit në masë të madhe si metodë për ngrohje në amvisëri por jo vetëm, për menaxhimin e mbeturinave dhe materialeve toksike, si dhe tëparasheh investime në energji të ripërtrishme dhe ngrohje alternative. Poashtu, në bashkëpunim me komunat, qeveria duhet të prezantoj një koncept të transportit kolektiv duke ofruar në të njejtën kohë edhe infrastrukturën adekuate për të arritur këtë gjë, të u jap qytetarëve mundësi udhëtimi të cilat promovojnë reduktimin e përdorimit të automjeteve, duke inkurajuar transportin alternativ. Qeveria duhet që të ndalë çdo iniciativë e cila në mënyrë direkte

³⁰Raporti për Vendin i Komisionit Evropian (fq.93), Tetor 2020. Linku: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

³¹“Lansimi Agjendës së Gjelbër: Mbështetja e BE në dekarbonizimin e Ballkanit Perëndimor”, Komisioni Evropian, 10 nëntor 2020. Linku: <https://ec.europa.eu/jrc/en/science-update/eu-support-decarbonising-western-balkans>

ose të tërthortë ndikon në shkatërrimin e lumenjve dhe liqeneve në vend. Në këtë drejtim, qeveria duhet të rishikoj të gjitha lejet që janë lëshuar deri më tani, dhe nëse ato nuk janë dhënë përkitazi me ligjin, duhet menjëherë të anulohen. Poashtu, qeveria duhet të ngris kapacitetet në monitorimin e duhur dhe të vazhdueshëm të zonave të mbrojtura ujore, por jo vetëm.

Përfundim

Si përfundim, Qeveria e Kosovës duhet të adresoj disa nga prioritetet e menjëhershme siç janë menaxhimi me pandeminë COVID-19 dhe imunizimi, rimëkëmbja ekonomike dhe krijimi i një identiteti ekonomik, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, reforma në administratë publike dhe përafrimi me BE-në, dialogu me Serbinë, reforma në arsim, dhe mbrojtja e mjedisit. Ajo çfarë mbetet më urgjente është që qeveria Kurti II të miratoj planin strategjik qeveritar deri në fund të muajit prill. Në përgjithësi, qeverinë e re e presin shumë procese reformuese po që se ekziston vullneti i mirëfillt institucional dhe politik për të përmirësuar gjendjen në shumë sektor, gjë që mbetet parakusht për zhvillim e mëtutjeshëm ekonomik e shoqëror.

SHËNIM I POLITIKAVE

Shënimi i politikave ofron analiza të shkurta, koncize dhe në kohë, mbi çështje të caktuara. Shënimet e Politikave janë raporte të shkurta të cilat përshkruajnë arsyet mbi përzgjedhjen e një alternative të caktuar të politikave mbi një çështje/debat aktual. Ato zakonisht publikohen për një ngjarje të caktuar dhe avokojnë qëndrime profesionale të Grupit për Studime Juridike dhe Politike. Më saktësisht, Shënimet e Politikave janë dokumente avokuese, të cilat ofrojnë argumente lidhur me përshtatjen/ndryshimet e një politike të caktuar. Shënimet e Politikave kanë për qëllim të ndikojnë një audience të synuar mbi rëndësinë/impikimet/zgjidhjet e një problemi aktual dhe me këtë rast sjellin rekomandime tek politik-bërësit, shoqëria civil dhe media, dhe publiku i gjërë.